




EKO-THERANDA
ne çfytë të ardhurës të gjatë



PLANI I BIZNESIT

**N.P.L “EKO-THERANDA” SH.A,
në Suharekë**

për

Periudhën 01.01.2026-31.12.2026

Tetor, 2025

PËRMBAJTJA:

1. Përmbledhje ekzekutive.....	3
1.1 Fushëveprimtaritë e ndërmarrjes.....	3
1.2 Qëllimi dhe misioni.....	4
2. Përshkrimi i përgjithshëm/ Historia e biznesit.....	5
2.1. Lokacioni dhe asetet ekzistuese.....	5
2.2. Vizioni	5
2.3. Misioni.....	6
2.4. SWOT Analiza.....	8
2.5. Masat për përmirësim dhe menaxhimin e sfidave.....	9
3. Produktet dhe shërbimet.....	9
3.1. Shërbimet primare	9
3.2. Shërbimet sekondare	10
3.3. Aktivitetet mbështetëse dhe zhvillimore	10
3.4. Qëllimi dhe vlera e shërbimeve	10
3.5. Vendndodhja dhe avantazhi operativ	10
4. Analiza e tregut dhe strategjia e marketingut.....	11
4.1. Objektivat dhe qasja e përgjithshme.....	11
4.2. Analiza e tregut.....	11
4.3. Strategjia e Marketingut.....	12
4.3. Anëtarësimi në PAMKOS.....	12
4.4. Plani i shitjes/ Të hyrat për vitin 2026.....	13
4.5. Plani buxhetor/Shpenzimet për vitin 2026.....	14
5. Analiza e konkurrenteve në tregun e synuar.....	15
6. Organizimi i ndërmarrjes.....	16
6.1 Personeli.....	16
6.2 Struktura Organizative.....	17
7. ANEKS I – Aktivitetet e nevojshme për realizim të planit.....	18

I. Përmbledhje Ekzekutive

Ndërmarrja Publike Lokale **N.P.L. "EKO-THERANDA" SH.A.** është themeluar duke u mbështetur në dy ligjet bazë që rregullojnë funksionimin e ndërmarrjeve publike në Republikën e Kosovës:

- **Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;**
- **Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare,** si dhe
- **Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2013,** mbi kriteret për krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe pjesëmarrjen e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit.

Me qëllim të themelimit dhe funksionalizimit të ndërmarrjes komunale **N.P.L. "EKO-THERANDA" SH.A.** në Suharekë, në **projekt buxhetin e vitit 2025** është planifikuar ndarja buxhetore në shumë prej **20,000.00 €**, si kapital fillestar për fazën e parë të operimit dhe fillimit të ofrimit të shërbimeve të parapara.

Sipas kontratës së nënshkruar ndërmjet **Komunës së Suharekës** dhe **N.P.L. "EKO-THERANDA" SH.A.** për vitin 2025, **vlera e planifikuar e të hyrave** është **124,683.38 €** (për 7 muaj operim, me planifikim mesatar mujor prej **17,811.91 €**).

Për vitin **2026**, ndërmarrja planifikon të vazhdojë operimin me të hyrat mujore të parashikuara në të njëjtin nivel si në vitin 2025, duke synuar njëkohësisht zgjerimin e fushëveprimit dhe kryerjen e shërbimeve shtesë, të cilat pritet të gjenerojnë të ardhura mujore shtesë dhe të kontribuojnë në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të ndërmarrjes.

Të hyrat kryesore për këtë periudhë do të realizohen nga "Kontrata në Shtëpi" e nënshkruar me Komunën e Suharekës, si dhe nga shërbimet shtesë që planifikohet të zhvillohen gjatë vitit e të cilat do të bëhen përmes kontratave të reja dhe të hyrave nga parkingjet.

Në të njëjtën kohë, ndërmarrja do të zbatojë masa për optimizimin e kostove operative, me qëllim rritjen e efikasitetit financiar dhe performancës ekonomike në ofrimin e shërbimeve publike.

Me qëllim të zgjerimit të gamës së shërbimeve, Ndërmarrja synon të nënshkruajë kontrata të tjera me Komunën e Suharekës.

I.1 Fushëveprimtaritë e ndërmarrjes

N.P.L. "EKO-THERANDA" SH.A. në bazë të statutit të sajë do të ushtrojë veprimtari në fushat vijuese:

- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike (parqe, sheshe, shtretër lumenjsh);
- Mirëmbajtja e varrezave të qytetit, varrezave të dëshmorëve dhe martirëve;
- Mirëmbajtja e shtatoreve, lapidarëve, përmendoreve dhe pllakave përkujtimore nën menaxhimin e komunës;

- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e vendparkimeve publike;
- Mirëmbajtja e hapësirave publike përreth banesave kolektive, përfshirë ashensorët;
- Mirëmbajtja e tregjeve të gjelbra;
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik;
- Dekorimi i qytetit në ditët e festave dhe ngjarjeve të rëndësishme;
- Sigurimi fizik i objekteve të institucioneve publike komunale;
- Intervenime emergjente në rrugët lokale publike (dëmtime, pengesa në qarkullim, mirëmbajtje e pushtave etj.).

Të gjitha shërbimet e lartpërmendura janë kompetencë e **N.P.L. "EKO-THERANDA" SH.A.**, ndërsa zgjerimi i tyre do të bëhet varësisht nga kapacitetet njerëzore dhe teknike që do të sigurohen nga aksionari (Komuna), nga mjete: vetanake të ndërmarrjes apo nga burime të tjera, përfshirë donatorët e ndryshëm.

Klasifikimi i veprimtarive sipas ARBK (NACE) - sipas klasifikimeve të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), **N.P.L. "EKO-THERANDA" SH.A.** ushtron këto veprimtari ekonomike:

1. 8130 – Aktivitetet e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe kujdesit të mjedisit (shesheve);
2. 8110 – Aktivitetet mbështetëse për menaxhimin e objekteve të kombinuara;
3. 8121 – Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave;
4. 8122 – Aktivitetet tjera të pastrimit të ndërtesave industriale;
5. 8129 – Aktivitetet tjera të pastrimit;
6. 9321 – Aktivitetet e parqeve të argëtimit dhe atyre me orientim specifik;
7. 3700 – Kanalizimi;
8. 3900 – Aktivitetet e riparimit dhe shërbimeve të tjera të menaxhimit të mbeturinave;
9. 4321 – Instalime elektrike;
10. 3821 – Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave jo të rrezikshme.

1.2 Qëllimi dhe misioni

Detyra thelbësore e **N.P.L. "EKO-THERANDA" SH.A.** është të ofrojë shërbime cilësore për qytetarët dhe komunën, në përputhje me standardet bashkëkohore të mirëmbajtjes dhe menaxhimit komunal.

Ky **Plan Biznesi** përcakton rrugën për ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme, efektive dhe efikase, në harmoni me standardet evropiane. Për realizimin e këtij qëllimi, Komuna e Suharekës do të sigurojë qëndrueshmëri financiare dhe racionalizim të përdorimit të fondeve publike.

N.P.L. "EKO-THERANDA" SH.A. do të jetë e përkushtuar në realizimin e aktiviteteve të planifikuara dhe, në bashkëpunim me Komunën, do të fillojë implementimin gradual të shërbimeve të parashikuara, me synim rritjen e cilësisë dhe të të hyrave të ndërmarrjes.

Kjo do të mundësojë zhvillim të qëndrueshëm dhe funksionim efikas në përputhje me legjislacionin përkatës.

2. Përshkrimi i Përgjithshëm/Historia e Biznesit

Ndërmarrja Publike Lokale "EKO-THERANDA" SH.A. është themeluar më 08.08.2024, pas nismës së Kryetarit të Komunës së Suharekës, z. Bali Muharremaj, dhe vendimit të Kuvendit Komunal të Suharekës Nr. 129/22, datë 30.03.2022. Kërkesa e komunës është adresuar tek Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht tek Ministria e Ekonomisë / Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, e cila ka miratuar themelimin me Vendimin e Qeverisë Nr. 09/165, datë 12 tetor 2023.

Ndërmarrja është krijuar si Shoqëri Aksionare dhe është regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) me emrin N.P.L. "EKO-THERANDA" SH.A. Suharekë.

2.1. Lokacioni dhe Asetet për Operim Optimal

Ndërmarrja Publike Lokale **N.P.L. "EKO-THERANDA" SH.A.** ka selinë e saj në **Komunën e Suharekës**, në hapësirat e siguruara përkohësisht nga **Komuna e Suharekës**, të cilat janë vënë në dispozicion për nevojat e ndërmarrjes deri në ndërtimin e objektit të ri administrativ të saj. Shfrytëzimi i këtyre aseteve të Komunës Suharekë përfshirë zyret, depot dhe mbështetja tjetër logjistike është conform Marrëveshjes në mes të NPL EKO-THERANDA dhe Komunës Suharekë nr. 1/2025 të datës: 25.04.2025.

Ndërtimi i objektit të ri të ndërmarrjes ka **filluar në fshatin Shirokë – Suharekë**, sipas planifikimeve buxhetore dhe procedurave të aksionarit dhe pas përfundimit të tij, do të mundësojë kushte optimale për funksionim dhe zhvillim të mëtejshëm të aktivitetit të ndërmarrjes.

Sa i përket **aseteve**, **N.P.L. "EKO-THERANDA" SH.A.** aktualisht operon me mjete dhe pajisje në bazë të **Marrëveshjes për shfrytëzim të mjeteve me K.R.M. "EKO-REGJIONI"**, marrëveshje kjo që mbetet në fuqi deri më **31.05.2026**. Kjo marrëveshje siguron mbështetje në fazën fillestare të operimit deri në konsolidimin e plotë të ndërmarrjes me asetet e veta.

2.2. Vizioni

Vizioni i këtij Plani të Biznesit është **ngritja e nivelit të ofrimit të shërbimeve komunale dhe përmirësimi i mjedisit jetësor**, duke krijuar një **ambient të pastër, të gjelbër dhe të qëndrueshëm** për qytetarët e Komunës së Suharekës. Ky vizion synon krijimin dhe mirëmbajtjen e **hapësirave gjelbëruese, këndeve të lojërave për fëmijë, zonave rekreative për të moshuar** dhe të gjitha ambienteve që kontribuojnë në cilësinë e jetës urbane dhe rurale.

2.3. Misioni

Misioni i ndërmarrjes është të mbulojë të gjithë territorin e Komunës së Suharekës me **shërbime cilësore, të qëndrueshme dhe efikase**, në përputhje me **standartet e Bashkimit Evropian** për menaxhim komunal dhe mjedisor.

N.P.L. "EKO-THERANDA" SH.A. synon të realizojë misionin e saj përmes **aktiviteteve primare dhe sekondare** të planifikuara në Planin e Biznesit.

Gjatë vitit **2025**, ndërmarrja ka planifikuar realizimin e aktiviteteve primare, për të cilat janë parashikuar **mjetet financiare të nevojshme**.

Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Ndërtimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike (parqe, sheshe, shtretër lumenjsh etj.);
- Mirëmbajtjen e varrezave të qytetit, varrezave të dëshmorëve dhe martirëve;
- Mirëmbajtjen e shtatoreve, lapidarëve, përmendoreve dhe pllakave përkujtimore që janë në menaxhim të komunës;
- Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e vendparkimeve publike;
- Mirëmbajtjen e tregjeve të gjelbra;
- Mirëmbajtjen e ndriçimit publik;
- Dekorimin e qytetit gjatë festave dhe ngjarjeve të veçanta.

Nëpërmjet këtyre veprimtarive, ndërmarrja synon të garantojë **shërbime komunale cilësore, transparencë në menaxhim, efikasitet operativ**, si dhe **përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së jetesës për qytetarët e Suharekës**.

Nga aktivitetet kryesore të renditura më sipër, **N.P.L. "EKO-THERANDA" SH.A.** do t'i kushtojë **rëndësi të veçantë menaxhimit të parkingjeve publike**.

Gjatë vitit **2026**, ndërmarrja synon të fillojë me **menaxhimin dhe mirëmbajtjen e vendparkimeve publike**, duke filluar fillimisht me **përgatitjen e bazës ligjore dhe rregullative për përcaktimin e tarifave të parkimit**, e më pas me **zbatimin praktik të tyre** në vendparkimet e përcaktuara, të cilat mund të menaxhohen në mënyrë më efikase dhe të kontrolluar.

Ky aktivitet do të kontribuojë në **rritjen e të hyrave vetanake të ndërmarrjes**, si dhe në **përmirësimin e qarkullimit dhe rendit urban** brenda qytetit të Suharekës.

Aktivitetet Sekondare të N.P.L. "EKO-THERANDA" SH.A.

N.P.L. "EKO-THERANDA" SH.A. planifikon të zhvillojë një sërë **aktiviteteve sekondare**, të cilat do të kontribuojnë drejtpërdrejt në **ofrimin e shërbimeve të integruara komunale** dhe në **përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve** të Komunës së Suharekës.

Aktivitetet sekondare të planifikuara përfshijnë:

- **Pastrimin e rrugëve dhe largimin e borës** në hapësirat publike të qytetit;
- **Mirëmbajtjen e hapësirave publike** përreth ndërtesave kolektive, duke përfshirë edhe **mirëmbajtjen e ashensorëve**;
- **Sigurimin fizik** të objekteve të institucioneve publike komunale;
- **Intervenimet emergjente** në rrugët lokale publike (përfshirë sanimin e dëmtimeve në rrugë, eliminimin e pengesave në qarkullim, si dhe mirëmbajtjen e pusëve dhe instalimeve të ngjashme);
- **Shërbime të tjera mbështetëse** që kontribuojnë në përmirësimin e mjedisit dhe të infrastrukturës komunale.

Zbatimi i aktiviteteve sekondare është planifikuar të **nisë në gjysmën e dytë të vitit 2026**, me synim që të **zgjerohet gradualisht në vitet pasuese**, në përputhje me **mundësitë financiare** që do të sigurohen përmes **të hyrave vetanake** të ndërmarrjes. Po ashtu, **Komuna e Suharekës** në cilësinë e aksionarit pritët të mbështetës ndërmarrjen me **mjete shtesë buxhetore**, varësisht nga **rritja e kapaciteteve operacionale** dhe **zgjerimi i gamës së shërbimeve** që do të ofrojnë ndërmarrja në të ardhmen.

2.4 SWOT ANALIZA E NDËRMARRJES

Përparësitë (Strengths)	Mundësitë (Opportunities)
-Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve publike për qytetarët; -Kontribut i drejtpërdrejtë në krijimin e një mjedisi më të pastër dhe të qëndrueshëm; -Racionalizimi i mjeteve buxhetore të Komunës përmes efikasitetit dhe efektivitetit të ofrimit të shërbimeve komunale; -Ekzistenca e partnerëve strategjikë (Komuna e Suharekës, institucionet qendrore, donatorët ndërkombëtarë dhe organizatat mbështetëse); -Pozicioni gjeografik i favorshëm dhe selia e ndërmarrjes në qytetin e Suharekës; -Baza ligjore e qëndrueshme dhe e favorshme për funksionimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve publike lokale; -Mbështetja institucionale nga Komuna dhe përfshirja e ndërmarrjes në planin zhvillimor lokal.	-Zgjerimi i gamës së shërbimeve komunale që ofrohen për qytetarët (përfshirë mirëmbajtjen, pastrimin, menaxhimin e parkingjeve, et.); -Krijimi i marrëveshjeve bashkëpunuese me komunat tjera dhe me sektorin privat për ofrimin e shërbimeve të përbashkëta; -Përfshirja në projekte të financuara nga donatorë ndërkombëtarë dhe programe zhvillimore që mbështesin ndërmarrjet publike lokale; -Përdorimi i teknologjive moderne për rritjen e efikasitetit dhe transparencës; -Rritja e ndërgjegjësimit qytetar për mjedisin dhe për shërbimet komunale, që ndihmon në rritjen e besueshmërisë dhe kërkesës për shërbime nga ndërmarrja.
Dobësitë (Weaknesses)	Rreziqet (Threats)
-Mungesa e përvojës së mjaftueshme menaxheriale dhe operacionale në disa fusha të reja të shërbimeve; -Mungesa e resurseve humane me përvojë të specializuar në fusha teknike dhe administrative; -Pajisje dhe mjete pune të pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha nevojat operacionale; -Vështirësi të vazhdueshme në inkasimin e të ardhurave nga kryerja e shërbimeve publike; -Kapacitete të kufizuara logjistike dhe mungesë e sistemit digjital për menaxhim dhe raportim të brendshëm.	-Mungesa fillestare e pajisjeve adekuate dhe e infrastrukturës teknike për operim të plotë, veçanërisht në fazën e parë të funksionimit; -Fleksibilitet i kufizuar operacional në periudhat e ngarkesave të larta, për shkak të mungesës së përvojës praktike të stafit; -Kosto e lartë e investimeve fillestare, veçanërisht në blerjen e mjeteve të punës dhe pajisjeve teknike; -Vonesat në pagesa nga palët kontraktuese apo qytetarët që mund të ndikojnë në stabilitetin financiar; -Ndryshimet e mundshme ligjore ose institucionale që mund të kufizojnë fushëveprimin e ndërmarrjes.

2.5. Masat për përmirësim dhe menaxhimin e sfidave

Për të adresuar dobësitë dhe për të minimizuar rreziqet, ndërmarrja planifikon:

- **Rekrutimin e stafit profesional dhe të kualifikuar**, në përputhje me nevojat e reja të shërbimeve;
- **Furnizimin me pajisje dhe mjete pune adekuate**, për të siguruar efikasitet dhe cilësi në kryerjen e detyrave;
- **Trajnimin e vazhdueshëm të resurseve humane** për ngritje të kapaciteteve teknike dhe administrative;
- **Zhvillimin e mekanizmave të qëndrueshëm të inkasimit të të ardhurave**, përmes sistemeve digjitale dhe bashkëpunimit me Komunën;
- **Hartimin e një plani afatmesëm investimesh**, për të garantuar qëndrueshmëri financiare dhe rritje të qëndrueshme të ndërmarrjes.

3. Produktet dhe Shërbimet

Ndërmarrja Publike Lokale **“Eko-Theranda” Sh.A.** në Suharekë ofron një gamë të gjerë shërbimesh komunale, që kanë për qëllim krijimin dhe mirëmbajtjen e një mjedisi të pastër, të rregullt dhe të sigurt për qytetarët e Komunës së Suharekës. Aktivitetet e ndërmarrjes ndahen në disa kategori kryesore:

3.1. Shërbimet primare

a) Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe gjelbërimit urban

- Pastrimi i rrugëve, shesheve, trotuareve dhe parqeve publike.
- Kujdesi dhe mirëmbajtja e gjelbërimit dekorativ, përfshirë krasitjen e drunjve, and mbjelljen e luleve sezonale dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve me bar.
- Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në hapësirat publike dhe vendosja e kosheve të mbeturinave në pikat strategjike të qytetit.

b) Mirëmbajtja e varrezave publike dhe përmendoreve

- Menaxhimi i varrezave të qytetit, si dhe atyre të Dëshmorëve dhe Martirëve.
- Mirëmbajtja e infrastrukturës së brendshme të varrezave (rrugicat, ndriçimi, gjelbërimi).
- Kujdesi për shtatore, lapidarët dhe përmendoret përkujtimore që janë nën menaxhimin e komunës.

c) Menaxhimi i ndriçimit publik dhe dekorimit të qytetit

- Mirëmbajtja e sistemit të ndriçimit publik në rrugë, parqe dhe zona rekreative.
- Instalimi i ndriçimeve dhe dekorimeve sezonale gjatë festave dhe ngjarjeve të rëndësishme kulturore.

3.2. Shërbimet sekondare

a) Menaxhimi i vendparkimeve publike

- Organizimi dhe administrimi i hapësirave të parkimit publik me pagesë.
- Sigurimi i mirëmbajtjes dhe sinjalistikës përkatëse për qarkullim të rregullt.
- Zhvillimi i sistemit elektronik të menaxhimit të parkimeve për efikasitet më të lartë.

b) Mirëmbajtja dhe menaxhimi i tregjeve të gjelbra

- Organizimi i tregjeve komunale për shitjen e produkteve bujqësore dhe artizanale.
- Sigurimi i kushteve higjieno-sanitare dhe mirëmbajtja e infrastrukturës për tregtarët dhe konsumatorët.

3.3. Aktivitetet mbështetëse dhe zhvillimore

- **Bashkëpunime publike-private (PPP)** për rritjen e kapaciteteve teknike dhe modernizimin e shërbimeve.
- **Zhvillimi i projekteve të qëndrueshme mjedisore**, si p.sh. Fërdorimi i energjisë së ripërtëritshme në ndriçimin publik ose menaxhimi ekologjik i mbetjeve.
- **Ofertimi i shërbimeve me pagesë për individë ose biznese private**, si pastrimi i hapësirave të gjelbra, mirëmbajtja e ambienteve publike apo dekorimi sezonal sipas kërkesës.

3.4. Qëllimi dhe vlera e shërbimeve

Qëllimi kryesor i NPL "Eko-Theranda" është:

- **Të përmirësojë cilësinë e jetesës së qytetarëve** përmes krijimit të një mjedisi të pastër, të sigurt dhe të favorshëm.
- **Të parandalojë përhapjen e sëmundjeve dhe epidemive** përmes menaxhimit efikas të mbetjeve dhe higjienës publike.
- **Të sigurojë qëndrueshmëri financiare** përmes menaxhimit racional të të hyrave dhe ofrimit të shërbimeve të reja me pagesë.

3.5. Vendndodhja dhe avantazhi operativ

Selia e ndërmarrjes ndodhet në qytetin e **Suharekës**, duke mundësuar reagim të shpejtë dhe ofrim efikas të shërbimeve për komunitetin lokal. Kjo afërsi operationale ndihmon në uljen e kostove logjistike dhe rritjen e cilësisë së ndërhyrjeve në terren.

Duke u mbështetur në përvojën shumëvjeçare dhe strukturën organizative profesionale, "Eko-Theranda" synon jo vetëm mirëmbajtjen e standardeve ekzistuese, por edhe zgjerimin e portofolit të shërbimeve në përputhje me nevojat në zhvillim të qytetit dhe komunës.

4. Analiza e tregut dhe strategjia e marketingut

4.1. Objektivat dhe qasja e përgjithshme

Në mënyrë që të arrihen objektivat e përcaktuara për periudhën **gusht – dhjetor 2024**, do të punohet në hartimin e disa formave të marketingut dhe në kombinimin e disa fushveprimtarive shërbyese, me qëllim që rezultati të jetë më i matshëm dhe më efikas. Synimi është të arrihen rritjet e parapara ekonomike në fushat e mirëmbajtjes, pastrimit dhe kujdesit për hapësirat gjelbëruese, si dhe në shërbime të tjera komunale.

Në këtë drejtim, do të zbatohen **strategjitë adekuate të marketingut** sipas llojit të shërbimeve dhe nevojave përkatëse, duke përdorur tre metoda strategjike:

- **Metoda zgjeruese**, e orientuar drejt klientëve të rregullt;
- **Metoda depërtuese**, e fokusuar në klientët potencialë;
- **Metoda e avancuar**, e orientuar drejt klientëve të rinj.

Për shërbimet ekzistuese do të zbatohet metoda zgjeruese, ndërsa për shërbimet e mirëmbajtjes së rrugëve dhe hapësirave gjelbëruese do të përdoret metoda që adreson boshllëqet e identifikuara në treg.

Në përmbushjen e objektivave të tjera të përmendura më lart, qasja e ndërnarrjes do të fokusohet në:

- Kontrollin e cilësisë së punëve në përputhje me rregulloret dhe standardet përkatëse;
- Aplikimin e teknologjisë moderne dhe mjeteve të reja në proceset e punës;
- Zbatimin e sistemit të shpërblimit dhe ndëshkimit në bazë të performancës;
- Trajnimin e stafit për ngritjen e kapaciteteve profesionale;
- Punësimin e stafit të ri sipas nevojës.

4.2. Analiza e tregut

Sipas të dhënave të **Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK)**, numri i përgjithshëm i banorëve në Komunën e Suharekës është **45,713 banorë**, që përfaqësojnë rreth **9,145 ekonomi familjare**.

NPL **“Eko-Theranda” Sh.A.** planifikon të mirëmbajë:

- Hapësirat publike (parqe, sheshe, shtretërit e lumenjve);
- Varrezat e qytetit, varrezat e Dëshmorëve dhe Martirëve;
- Shtatorët, lapidarët, përmendoret dhe pllakat përkujtimore që menaxhohen nga komuna;
- Vendparkimet publike;
- Hapësirat publike përreth banesave kolektive dhe ashensorët;
- Tregjet e gjelbra;
- Ndriçimin publik;

- Dekorimin e qytetit gjatë festave;
- Sigurimin fizik të objekteve të institucioneve publike komunale;
- Intervenimet emergjente në rrugët lokale publike (p.sh. dëmtime në rrugë, pengesa në qarkullimin e trafikut, probleme me pusetat etj.).

4.3. Strategjia e marketingut

Duke marrë parasysh gjendjen jo të kënaqshme të mirëmbajtjes së hapësirave publike të gjelbërta (përfshirë parqet, lumenjtë, sheshet dhe parkingjet), si dhe nevojën për përmirësim të shërbimeve të pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve publike, paraqitet nevoja për një **angazhim më të drejtpërdrejtë** në përmirësimin e cilësisë së këtyre shërbimeve.

Për këtë qëllim, ndërmarrja do të përdorë mjete të ndryshme komunikimi si **televizionet lokale, billboardet, fletushkat dhe Qendrat Rinore/Komunitare lokale**, me synim rritjen e **vetëdijes së qytetarëve** për rëndësinë e ruajtjes së ambientit dhe shërbimeve komunale.

Gjatë vitit **2026**, planifikohet zhvillimi i aktiviteteve promovuese që nënvizojnë rolin e ndërmarrjes në ofrimin e shërbimeve publike, të cilat do të shtrihen në tërë territorin e komunës.

Me ofrimin e shërbimeve të rregullta, pritet të ketë **ulje të ankesave të qytetarëve**. Ndërmarrja planifikon të realizojë një **studim mbi kënaqshmërinë e klientëve**, përmes angazhimit të një **organizate joqeveritare ose instituti të specializuar**.

Disa nga indikatorët që do të maten pas një periudhe njëvjeçare janë:

- Përqindja e qytetarëve plotësisht të kënaqur me cilësinë e shërbimeve;
- Përqindja e qytetarëve të kënaqur me kohën e reagimit dhe ofrimit të shërbimeve;
- Përqindja e qytetarëve të kënaqur me sjelljen dhe profesionalizmin e punëtorëve;
- Përqindja e qytetarëve të kënaqur me informimin publik dhe transparencën;
- Përqindja e qytetarëve që vlerësojnë pozitivisht performancën e ndërmarrjes.

Ndërmarrja do të forcojë bashkëpunimin me **inspektorët komunalë** dhe subjektet e tjera relevante, për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve publike.

4.4. Anëtarësimi në PAMKOS

Ne vitin 2026 NPL EKO-THERANDA planifikon të anëtarësohet në PAMKOS (Shoqata për Pastërti dhe Ambientit të Kosovës).

Anëtarësimi i EKO-THERANDA në Shoqatën PAMKOS është i domosdoshëm për të forcuar bashkëpunimin me ndërmarrjet e tjera publike të Kosovës, për të rritur kapacitetet profesionale dhe për të përfituar nga avokimi i përbashkët në raport me institucionet shtetërore. Përmes kësaj platforme gjithëpërfshirëse, EKO-THERANDA do të ketë mundësi të shkëmbejë praktika të mira, të avancojë cilësinë e shërbimeve dhe të kontribuojë në vetëdijësimin e qytetarëve për një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm në Suharekë dhe në nivel kombëtar.

4.5. Plani i shitjes/ Të hyrat

Qëllimet kryesore të NPL “Eko-Theranda” Sh.A. janë:

- Të ofrojë shërbime cilësore për qytetarët e Komunës së Suharekës;
- Të realizojë investimet e nevojshme, qoftë nga të hyrat vetanake apo nga donatorë të mundshëm;
- Të zvogëlojë shpenzimet operative;
- Të përmirësojë faturimin dhe inkasimin;
- Të zgjerojë shërbimet në rajonet rurale dhe në fushat që kërkojnë ndërhyrje urgjente, të cilat nuk mbulohen nga ndonjë organizatë tjetër publike.

Këto qëllime do të mbështeten përmes:

- Ristrukturimit të organizimit të brendshëm për rritjen e efikasitetit;
- Planeve efikase të operimit të stafit në përputhje me metodat bashkëkohore të punës;
- Bashkëpunimit me institucionet publike dhe organizatat joqeveritare.
- Rritjes së aktiviteteve të marketingut dhe vetëdijesimit publik për mjedisin;
- Përgatitjes së fletushkave dhe spoteve promovuese në bashkëpunim me **Ministrinë e Mjedisit** dhe agjenci të tjera përkatëse.

Fokusi kryesor për këtë vit do të jetë **konsolidimi i brendshëm teknik, organizativ dhe ligjor**, si bazë për zhvillimin e mëtejshëm të ndërmarrjes.

Buxheti i paraparë nga komuna do të përdoret për:

- Resurset njerëzore (paga dhe meditje);
- Kontribute dhe obligime ligjore;
- Mallra dhe shërbime operative;
- Shpenzime komunale;
- Investime kapitale në masë të kufizuar.

Në fillim të vitit 2026, Ndërmarrja do të ketë në dispozicion **10,500.00 €**, si kapital **filestar**, të siguruar nga mjetet buxhetore nga operimi dhe kryerja e shërbimeve sipas kontratës në shtëpi të vitit 2025 gjatë shtatë muaj operimi.

Në periudhën **2026 – 2028**, ndërmarrja planifikon të zhvillojë afarizmin me **trend të qëndrueshëm rritës**, përmes të hyrave vetanake dhe me **mbështetje nga qeveria komunale, qendrore dhe organizatat ndërkombëtare** që veprojnë në Kosovë dhe rajon.

NPL “Eko-Theranda” Sh.A. për vitin buxhetor 2026 do të bazohet në buxhetin e ndarë nga **Komuna e Suharekës**, si aksionari i vetëm i shoqërisë. Për shkak të periudhës së shkurtër të funksionimit dhe arsyeve objektive, ndërmarrja nuk do të mund të ofrojë të gjitha shërbimet e planifikuara që në fillim.

Të hyrat buxhetore të planifikuara për vitin 2026:

Nr	Përshkrimi projekti/ shërbimit publik	Njësia	Sasia	Shuma	Total /në Euro (€)	Lloji i të Hyrave	
						Të hyrat Shitja/ Operimi	Të hyra Buxheti komunal/Dona tori
1	Të hyra mujore sipas kontratës në Shtëpi për Mirembajtjen e hapësirave publike	Muaj	12	17,811.91	213,742.92	213,742.92	0.00
2	Të hyra mujore nga parkingjet	Muaj	8	2,500.00	20,000.00	20,000.00	0.00
1	Mjetet buxhetore nga operimi dhe kryerja e shërbimeve sipas kontratës në shtëpi të vitit 2025	Muaj	7	1,500.00	10,500.00	10,500.00	0.00
Totali:					244,242.92	244,242.92	0.00

4.6 Plani buxhetor/Shpenzimet për vitin 2026

Buxheti i planifikuar për periudhën: 01.01.2026 – 31.12.2026

Nr.	Shpenzimet	Vlera totale për vitin fiskal 2026 në €	Vlera totale për vitin fiskal 2027	Vlera totale për vitin fiskal 2028
1	Paga dhe mëditje	144,000.00	172,800.00	207,360.00
2	Mallra dhe shërbime	4,800.00	5,760.00	6,912.00
3	Shpenzime komunale	2,400.00	2,880.00	3,456.00
4	Investime kapitale	12,000.00	14,400.00	17,280.00
5	Shpenzime për pagesa të kontributeve dhe tatimeve	42,000.00	50,400.00	60,480.00
6	Tarifa e anëtarësimit në PAMKOS	1440.00	1440.00	1440.00
Total:		206,640.00	247,680.00	296,928.00

5. Analiza e konkurrentëve në tregun e synuar

Për të siguruar një ndjekje të vazhdueshme dhe në kohë reale të zbatimit dhe rezultateve të këtij plani biznesi, NPL **EKO-THERANDA** do të aplikojë një sistem të mirëpërcaktuar të monitorimit dhe vlerësimit të performancës. Ky sistem do të mundësojë identifikimin e hershëm të devijimeve nga objektivat dhe marrjen e masave korrigjuese në kohë.

Në kuadër të analizës së konkurrentëve dhe të pozicionimit tonë në tregun e synuar, do të përdoren mekanizma matës dhe indikatorë kyç të performancës (KPI), të ndarë sipas fushave të veprimit, si më poshtë:

- **Monitorimi i performancës financiare:**
 - Realizimi i të hyrave krahasuar me planin financiar;
 - Kontrolli i shpenzimeve operative dhe administrative;
 - Monitorimi i nivelit të inkasimit të mjeteve financiare.
- **Monitorimi i tregut dhe konkurrentëve:**
 - Analiza e rritjes apo rënies së kërkesës për shërbimet tona;
 - Vlerësimi i zhvillimeve në ofertat konkurrense dhe çmimeve në treg;
 - Identifikimi i tregjeve të reja potenciale dhe mundësive për zgjerim.
- **Monitorimi i klientëve dhe shërbimeve:**
 - Përfitimi i klientëve të rinj dhe mbajtja e klientëve ekzistues;
 - Matja e kënaqshmërisë së klientëve përmes anketave periodike;
 - Analiza e reagimeve dhe rekomandimeve të klientëve për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.
- **Monitorimi i operacioneve dhe resurseve:**
 - Përdorimi racional dhe efikas i mjeteve lëvizëse dhe pajisjeve;
 - Realizimi i shërbimeve publike dhe të projekteve në afatet e përcaktuara;
 - Mbikëqyrja e zbatimit të projekteve kapitale në përputhje me buxhetin dhe kohën e planifikuar;
 - Funksionimi efektiv i sistemit të komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm përmes takimeve të rregullta me klientët dhe partnerët e bashkëpunimit.

Këto mekanizma do të mundësojnë që **EKO-THERANDA** të ketë një pasqyrë të qartë mbi performancën e saj konkurruese, të reagojë me fleksibilitet ndaj ndryshimeve në treg dhe të ruajë një avantazh strategjik përballë konkurrentëve.

6. Organizimi i NPL “EKO-THERANDA” SH.A

Në bazë të plotësimit ndryshimeve që janë bërë në Rregulloren e Brendshme Organizative, Ndërmarrja përbëhet nga menaxhmenti – administrata si dhe pjesa e operativës e cila aktivitetet do t'i kryejë në komunën e Suharekës.


Skema organizative – organogrami i menaxhmentit të N.P.L. “EKO-THERANDA” – Suharekë:

6.1. Personeli

Sektorët e punësimit:

Nr.Sipas RRB	Administrata:	Nr. i punonjësve aktual	Numri i punonjësve sipas Rregullores së Brendshme	Pregatitja profesionale
I	Bordi i Drejtorëve	3	4	Universitar
3.1	Kryeshefi Ekzekutiv (KE)	1	1	Universitar
3.2	Zyrtari/e Kryesor Financiar dhe i Thesarit	0	1	Universitar
3.3	Sekretar i/e Përgjithshëm	0	1	Universitar
3.4	Zyrtari i Auditimit të Brendshëm	0	1	Universitar
3.5	Zyrtari i Prokurimit	0	1	Universitar
3.6	Zyrtari i për burime njerëzore	0	1	Universitar
3.7	Zyrtar/e për logjistikë	0	1	Universitar
3.8	Depoisti	1	1	Mesëm
3.9	Arkëtari	1	1	Universitar
3.10	Inkasanti	0	1	Mesëm/ pref.Universitar
3.11	Zyrtar për regjistrimin e pasurive	0	1	Universitar
3.12	Zyrtar/e administrative	0	1	Universitar
3.13	Zyrtari për mbrojtje të mjedisit	0	1	Universitar
	Gjithsej administratë	6	17	
3.14	Shërbimi i Mirëmbajtjes			
3.14.1	Kryepunëtorë	2	2	Mesëm
3.14.2	Punëtor/e Fizik	11	11	Fillor
3.14.3	Punëtor/e Sigurim fizik – Roje	0	10	Mesëm
3.14.4	Shtëpiaku/e	0	3	Mesëm
3.14.5	Vozitës i/e mjeteve të punës	0	1	Mesëm
3.14.6	Vozitës i/e mjeteve të rënda	0	1	Mesëm
		13	13	

6.2 STRUKTURA ORGANIZATIVE E NDËRMARRJES PUBLIKE LOCALE "EKO-THERANDA" SH.A. NË SUHAREKË:



PLANI I BIZNESIT I N.P.L "EKO-THERANDA" SH.A, në Suharekë për periudhën 01.01.2026-31.12.2026, është miratuar nga Bordi i NPL-së, në takimin e bordit me datë: 30.10.2025.